

VENDIM
Nr. 665, datë 10.11.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 586, DATË 30.8.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PUNËSIMIN E PËRKOHSHËM TË STUDENTËVE TË
EKSELENCËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të kreut III, të vendimit nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përfundimisht për vitin 2021:

a) pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës, për këtë vit, të plotësohen nga kandidatët e përzgjedhur nëpërmjet platformës “Gati për Shqipërinë”, sipas së njëjtës metodologji të vlerësimit të kandidatëve të përcaktuar në pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi;

b) Departamenti i Administratës Publike të zhvillojë procedurën e radhës së punësimit të përkohshëm të studentëve të ekselencës, sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi, nëse në përfundim të procedurës së zhvilluar sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, mbeten ende pozicione vakante të dedikuara për studentët e ekselencës.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama